

20252004023

Në bazë të nenit 27 paragrafit (6) të Ligjit për Arsimin Profesional dhe Trajnimin ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 3/25 dhe 74/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës, solli

RREGULLORE PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E UDHËHEQJES SË REGJISTRIT PËR VERIFIKIMIN E PUNËDHËNËSVE PËR ARSIMIN PRAKTIK

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet forma, përmbajtja dhe mënyra e udhëheqjes së Regjistrit për verifikimin e punëdhënësve për arsimin praktik (në tekstin e mëtejme: Regjistri).

Neni 2

Regjistri udhëhiqet në formë elektronike nga odat, për punëdhënësit të cilët kanë kaluar procesin e verifikimit.

Neni 3

Regjistri përmban në veçanti të dhënat e mëposhtme për secilin punëdhënësit të verifikuar:

- emri i punëdhënësit,
- selia/adresa, komuna,
- numri amë i subjektit,
- numri i vetëm i taksës,
- të dhënat e kontaktit (telefon dhe posta elektronike),
- veprimtari sipas Klasifikimit Kombëtar të Veprimtarive,
- kualifikime arsimore për të cilat punëdhënësi ofron arsim praktik dhe
- numri dhe data e Aktvendimit për verifikimin e punëdhënësit për realizimin e arsimit praktik.

Neni 4

Punëdhënësit regjistrohen në Regjistrin e odës përkatëse me parashtrimin e kërkesës e cila publikohet në faqen e internetit të odave dhe Aktvendimin për verifikimin e punëdhënësit për realizimin e arsimit praktik të nxënësve.

Neni 5

Regjistri përditësohet rregullisht në bazë të Aktvendimeve të sjellura për verifikim apo Aktvendimeve për anulimin e verifikimit nga odat.

Kërkesë për përditësimin e të dhënave të tyre në Regjister mund të parashtrojnë edhe punëdhënësit pranë odës.

Neni 6

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, ndalon së vlefshmi Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së Regjistrit për verifikimin e punëdhënësve për trajnim praktik të nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/08).

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës së publikimit të tij në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 18-12537/1
25.9.2025
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
Prof. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.